



Republika e Kosovës


Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

ZYRA E KRYEMINISTRIT/ OFFICE OF THE PRIME MINISTER/ URED PREMIJERA

AGJENCIA PËR BARAZI GJINORE / AGENCIJA ZA RAVNOPRAVNOST POLOVA/

AGENCY OF GENDER EQUALITY



**Raporti i Komisionit për Shqyrtimin e Kontesteve dhe Ankesave të aplikantëve për përfitim nga Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike 2021 Masa 4 për mbështetje financiare për OJQ-të**

**Masa 10 "Mbështetje financiare për projektet dhe iniciativat që synojnë fuqizimin e rolit të gruas në shoqëri dhe ekonomi - Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike 2021" – Masa 4 e Fazës së dytë**

Agjencia për Barazi Gjinore/ ZKM ka bërë thirrje me datën 28 Janar 2021 për mbështetje financiare të OJQ-ve për përfitim nga Masa 10 "Mbështetje financiare për projektet dhe iniciativat që synojnë fuqizimin e rolit të gruas në shoqëri dhe ekonomi - Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike 2021" – Masa 4 e Fazës së dytë.

Bazuar në Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës - Programin për Rimëkëmbje Ekonomike, Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitet 2020-2023, me qëllim ruajtjen e shëndetit publik dhe ekonomik të vendit në situatën e krijuar nga COVID-19 dhe vendimin e Qeverisë nr 06/58 datë 14.01.2021 për Zbatimin e Programit për Rimëkëmbjen Ekonomike për vitin 2021 Masa 4 për mbështetjen financiare për projektet dhe iniciativat që synojnë përmirësimin pozitës së gruas në shoqëri dhe ekonomi dhe vendimit nr 04-59 të datës 27.01.2021 dhe nr 06/60 të datës 27.01.2021 të aprovuar nga Qeveria e Kosovës, ABGJ me datë 12.03.2021 ka shpallë listën e përfituesve të shqyrtuar nga Komisioni vlerësues për përzgjedhjen e projekteve<sup>1</sup> për mbështetje financiare të institucioneve, Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike 2021, dhe ka pranuar ankesat deri me datë 19.03.2021.

<sup>1</sup> Vendimi i KE ABGJ për themelimin e Komisionit vlerësues për vlerësimin e projekteve të OJQ të grave dhe bizneseve të vogla të udhëhequra nga gratë për "Mbështetje financiare për projektet dhe iniciativat që synojnë fuqizimin e rolit të gruas në shoqëri dhe ekonomi - Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike 2021" – Masa 4, nr 026/21 datë 29.01.2021

- Gjithsejtë tetë (8) ankesa nga ana e aplikuesve për mbështetje financiare, nga OJQ-te.
- Pas shqyrtimit, Komisioni në bazë të dokumenteve të dorëzuara nga secili aplikant si dhe bazuar në ankesë, në bazë të kriterëve të vendosura për zbatimin e Masë 10-të faza 2 – masa 4, bazuar ne Rregulloren 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik te OJQ-ve dhe legjislacionit ne fuqi vendosi si më poshtë:
  - Aprovimin e një (1) ankese si të bazuara dhe
  - Refuzimin e shtatë (7) ankesave për mos përmbushje të kriterëve.


| Nr. | Emri i biznesit                  | Emri dhe mbiemri i personit te autorizuar | Komuna    |
|-----|----------------------------------|-------------------------------------------|-----------|
| 1   | Iniciativa Rinore<br>Aktive- IRA | Qendresa Jashanica<br>Dermaku             | Prishtinë |

ANËTARËT E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E KONTESTEVE DHE ANKESAVE

*[Signature]*

Богданов

Shogun



<sup>2</sup> Vendimi i KE ABGJ për themelimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave për OJQ